



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

Procesverbal i mbajtur më 27 tetor 2023, në mbledhjen e XVI-të (gjashtëmbëdhjetë) mandati VII-të i Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në ndërtesën e re të Komunës, dhe filloi në orën 10:10.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti, dhe atë; (Naim Çunaku; Arnisa Sylejmani; Haki Rudari; Drita Pajaziti; Sebastina Vokri; Bashkim Sylja; dhe Mrika Thaçi, përveç Qëndrim Softollit i cili mungoi) bashkëngjitur lista e nënshkrimeve.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje i pranishëm ishte edhe; Vigan Salihu drejtor i Drejtorisë së planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik-DPZHE, znj.Lirie Hoti drejtoresh e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-DBPZHR.

Rendi i ditës

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit dhe duke i'u dëshiruar punë të mbarë në këtë mbledhje, konstatoi kuorumin, ndër të tjera theksoi, besoj se me rendin e ditës jeni të njoftuar sepse materiali ju është përcjellë me kohë, kemi vetëm 3 pika të rendit të ditës, materiali nuk është i ngarkuar si herëve të tjera, nëse dikush ka për të shtuar diçka rreth rendit të ditës urdhëroni.

znj.Drita Pajaziti, theksoi, kam një propozim si pikë të rendit të ditës për seancën e radhës së Kuvendit, duke marrë para sysh faktin se jemi në fund të muajit tetor, muaj ky që njihet si muaji rozë ose muaji i kancerit të gjirit dhe për këtë gjë komuna e ka ofruar mamografinë falas gjatë këtij muaji. Unë besoj se nuk është e mjaftueshme kjo fushatë vetëdijësuese andaj propozoj që Kuvendi i Komunës të marrë vendim në seancën e radhës që mamografia të ofrohet falas për tërë vitin.

Kryesues i Komitetit, theksoi, propozimi i znj.Drita Pajaziti është që shërbimi mamografisë për qytetarët të jetë falas për tërë vitin, kur dihet se ky vit i ka edhe dy muaj.

znj.Drita Pajaziti, theksoi, propozimi im ishte që mamografia të ofrohet gjithëherë falas për qytetarët (femrat) e Komunës së Podujevës, edhe pse ndoshta ajo shumë e caktuar për dikë mund të jetë shumë e madhe.

z.Naim Çunaku, theksoi, nuk e di cila është arsyeja pse duhet të merret ky vendim përmes Kuvendit, si pikë e rendit të ditës mund të debatohet gjendja shëndetësore, por të jetë si pikë e rendit të ditës dhe të merret vendim për mamografinë nuk e shohë të arsyeshme.

z.Haki Rudari, theksoi, Kuvendi i Komunës ka të drejtë të marr vendim që kontrolli shëndetësor për mamografinë të ofrohet falas.

Kryesues i Komitetit, theksoi, së pari për këtë çështje duhet konsultuar me drejtorin e DBF-së.

z.Bashkim Sylja, theksoi, ky vendim ka mundur të merret nga DSHMS, për lirim nga taksa ose pagesa për mamografinë, sepse pastaj do të ndryshohet edhe pagesa për shërbimet tjera që ofron QKMF-ja.

Sa kam njohuri unë ka edhe një propozim për Ndërmarrjen Publike Lokale "EKO LLAPI", prandaj është mirë të konsultohemi mes veti e mos të bëjmë gabime në vendimmarrje përndryshe vendimi për lirim nga taksa ose pagesa për mamografinë mund të merret nga ana e Kuvendit, por më mirë do të ishte diskutimi

rreth kësaj teme dhe të merren fushata sensibilizuese, mirëpo së pari duhet të konsultohemi mes veti para se të fillojë seanca e Kuvendit.

z.Naim Çunaku, theksoi, sa kam kuptuar unë znj.Drita Pajaziti propozon që Kuvendi të marr vendim për largimin e pagesës për mamografinë për një muaj.

znj.Drita Pajaziti, theksoi, propozimi im ishte që mamografia të ofrohet gjithherë falas.

z.Naim Çunaku, theksoi, unë nuk e di se çka është e përcaktuar në Rregullore, por e di se është bërë sensibilizimi rreth trajtimit, gjegjësisht rrezikun që shfaqet nga sëmundja e kancerit të gjirit dhe e di nga niveli qendror janë blerë mjete mobile për zbulimin e kancerit të gjirit në fazën e parë.

Nuk e di nëse pacientët e Komunës së Podujevës duhet të paguajnë tarifë për këtë shërbim, nëse është kjo tarifë, znj.Drita Pajaziti duhet të na shpjegoj se a kemi ne specifikisht pagesë prej 2€ për shërbimin e mamografisë.

znj.Drita Pajaziti, theksoi, realisht gjatë muajit tetor që njihet si “muaji rozë” Komuna e Podujevës për 3 vite radhazi e ofron këtë shërbim falas, kurse gjatë muajve tjerë të vitit ky shërbim kushton 2€ dhe atë sipas Rregullores për Taksa Tarifa dhe Gjoha Komunale, kërkesa ime është që ky shërbim për mamografin në shumë prej 2€ të hiqet dhe ky shërbim të jetë falas.

z.Haki Rudari, theksoi, propozimi i cilitdo këshilltar vihet në votim për arsye se Rregullorja e parasheh që propozimi hedhet në votim, çështjen të cilën znj.Drita Pajaziti e trajton është konform Rregullores prandaj Kuvendi i Komunës ka të drejtë ta marrë këtë vendim. Kontrolli falas për mamografi qenka vetëm për muajin tetor dhe tani kemi një propozim që kontrolli për mamografi të jetë falas në kohë të pa caktuar, prandaj fushata sensibilizimi që është duke u bërë nga Ministria dallon nga kjo kërkesë që e propozoi zonja Pajaziti ngase ajo është një fushatë për muajin tetor. Prandaj është një çështje që është në interes të të gjithëve sepse ka të bëjë me shëndetin dhe nuk duhet të bëhet kjo temë e madhe.

Ky propozim nuk ka të bëjë asgjë me çështjet tjera sepse secila pikë e ka atë rëndësinë dhe kohën e tij, ky propozim është teje njerëzor dhe human në mënyrë që të përfitojnë nga kontrollet qytetaret e gjinisë femërore.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, sa për sqarim, së pari është një propozim dhe rreth këtij propozimi pati diskutim, pastaj ky propozim hedhet në votim.

z.Bashkim Sylja, theksoi, problemi nuk është që ky propozim të hedhet në votim ose jo, a i ka votat e mjaftueshme apo jo, nuk besoj se dikush mund të jetë kundër kësaj iniciative, mirëpo ne thjeshtë kërkuam informata më shumë që mos të biem ndesh me Rregulloren e Kuvendit, nuk e di për momentin se a ka pas mundësi të merret ky vendim pa u sjellë fare në Kuvend, përndryshe ky propozim e ka mbështetjen dhe askush prej asamblistëve nuk e diskutojë këtë sepse asnjëri prej nesh nuk ishte kundër, mirëpo sqarimi dhe informimi për pikën e rendit të ditës është njerëzor sepse për këtë arsye ne jemi këtu.

z.Haki Rudari, theksoi, sa i përket propozimeve ne e dimë që KPF i propozon dhe i rekomandon Kuvendit Komunal, prandaj diskutohet dhe në fund vendimet i merr Kuvendi i Komunës, kurse ne si KPF kemi të drejtë propozimin ta nxjerrim si rekomandim për Kuvend. Sa i përket çështjeve tjera natyrisht se janë temë e diskutimit në seancën e radhës. Edhe njëherë po e përsëris, çdo propozim që vije nga secili këshilltar/e në Rregullore ceket se duhet të zbatohet, kushdo që bënë propozime të njëjtat duhet të hedhen në votim.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, i nderuari z.Haki Rudari, këtu ka ndodhur një keqkuptim sa i përket procedurës së votimit që e ceket ju, ne e dimë që ekziston një Rregullore për Taksa Tarifa dhe Gjoha Komunale, dhe ne në atë Rregullore nuk mund të ndërhyjmë pa i përfillë procedurat përkatëse ligjore për ta ndryshuar atë, prandaj askush nuk është kundër propozimit të znj.Drita Pajaziti, sepse është propozim i qëlluar dhe të gjithë ne e përkrahim atë vendim, mirëpo a duhet ndryshuar Rregullorja e cekur për atë tarifë ne duhet ta sqarojmë.

z.Haki Rudari, theksoi, vetëm ajo pjesë e tarifës hiqet kurse pjesa tjetër e Rregullores mbetet ashtu siç ka qenë.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, duhet ndryshuar Rregullorja për Taksa Tarifa dhe Gjoha Komunale në mënyrë që të hiqet ajo tarifë, ne mund ta votojmë këtë propozim por biem në kundërshtim me vetveten, përkatësisht me Rregulloren që e kemi miratuar në këtë Kuvend.

znj.Arnisa Sylejmani, theksoi, ne këtu jemi diskutuar rreth një propozimi i nderuari koleg z.Haki Rudari, nuk e shohë të arsyeshme përse ti duhet të ngrihesh në këmbë dhe të thoni mos diskutoni rreth këtij propozimi kur ti ishe kundër kësaj pike, e ceku edhe kryesuesi se është tepër pikë me vend dhe meqenëse jemi në muajin tetor që njihet si “muaji rozë” duhet të diskutojmë rreth kësaj pike, ne vetëm kërkuam dhe duam ta dimë si informatë se a është legjitime dhe a duhet të silltet në Kuvend.

znj.Drita Pajaziti, theksoi, ne mund të iniciojmë procedurën për ndryshimin e Rregullores për taksa Tarifa dhe Gjoha Komunale, prandaj ky rekomandim mund të kalojë për seancën e radhës dhe të ndryshohet kjo pikë, këtë praktikë që e them nuk e ka vetëm komuna jonë, shërbimin e mamografisë e ofrojnë falas edhe dy komuna tjera si ajo e Mitrovicës dhe e Prizrenit, është një iniciativë që mund ta ndër marrim së bashku sepse është në të mirë të të gjithëve.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, ne këtu nuk mund të mendojmë politikisht sepse jemi së bashku në këtë çështje dhe nuk dua që të politizohet ky propozim, por këtu jemi duke diskutuar për mënyrën më të mirë që të kalojë ky propozim.

z.Bashkim Sylja, theksoi, le të bëhet propozimi për ndryshim plotësimin e Rregullores në fjalë, konkretisht të largohet taksa për shërbimin e mamografisë dhe të kalojë ky propozim si rekomandim për seancën e radhës.

z.Naim Çunaku, theksoi, unë po e shohë që po ceket Rregullorja e Punës së Kuvendit, por ju them se për çdo propozim hapet debat dhe Grupet e këshilltarëve normalisht se japin mendimet e tyre për mbështetje apo refuzim të atij propozimi, prandaj këtu nuk ishte punë debati, këtë po e them për z.Haki Rudari.

Sa i përket çështjes, gjegjësisht materies të cilën znj.Drita Pajaziti e propozoj, nuk dua ta përsëris sepse askush nuk mund të jetë kundër dhe mos ta përkrah një çështje siç është ky propozim për kancerin e gjirit, gjegjësisht mamografinë. Të gjitha këto dileme nëse janë të përcaktuara me Rregullore për taksa Tarifa dhe Gjoha Komunale, tani ne në rend të parë duhet ta atakojmë atë rregullore, konkretisht atë dispozitë të Rregullores duhet ta tërheqim dhe në këtë kontekst mendoj se do duhej të ishte propozimi për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për Taksa Tarifa dhe Gjoha Komunale, konkretisht heqjen e nenit që e parasheh tarifën për shërbimin e mamografisë. Pra më tepër kemi të bëjmë me një vendim që ka të bëjë me ndryshim e Rregullores sepse askush s'mund të jetë kundër një shërbimi çfarë kërkohej dhe t'ju lehtësohet shërbimi pacientëve që në fazën e parë e zbulojnë sëmundjen e kancerit, këtu s'ka grupime politike për çështje jetike të qytetarëve.

z.Haki Rudari, theksoi, po i përgjigjem kolegut z.Naim Çunaku, në bazë të Rregullores së punës, propozuesi apo iniciuesi bën propozimin e tij i cili hedhet në votim, mënyra më e mirë që ti e ndihmon është që të votosh për, kundër apo të abstenosh. Ti mund ta bësh një propozim në emër të Grupit, unë propozimin tënd e ndihmoj kur votoj për, kundër ose abstenoj, kjo është procedura e përcaktuar në Rregullore. Në këtë rast znj.Drita Pajaziti e arsyeton propozimin e saj, pastaj ai propozim hedhet në votim. Kushdo nga ne mund të bëjë propozime qoftë prej këshilltarëve apo edhe nga drejtorët e Drejtorive prandaj ne këtu nuk e di pse të debatojmë më shumë rreth këtij propozimi.

z.Naim Çunaku, theksoi, atë që e thua propozuesi të bëjë arsyetimin e propozimit është më se normale por s'mund t'ia ndalosh Grupeve politike të shfaqin qoftë edhe publikisht ose t'i thërrasin edhe kolegët e tyre që ta mbështesin ose jo një propozim, dhe këtu s'ka debat, por s'do të thotë t'ia ndalosh Grupeve politike të përfaqësuarë në këtë Komitet që të shfaqin publikisht mbështetjen ose refuzimin e propozimit

dhe për çdo propozim të bërë në foltore e kam të drejtën ta thërras Grupin të votoj për ose kundër apo të abstenoj, ky ishte qëllimi.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, ne këtu jemi për të mos penguar askënd, por jemi duke debatuar në mënyrë që mos t'i shkelim procedurat ligjore, përndryshe ne mund t'i rekomandojmë Kuvendit propozime të ndryshme.

Për të mos e zgjatë më shumë këtë temë, e vë në votim propozimin e znj.Drita Pajaziti, për përfshirje në kuadër të rendit të ditës si pikë shtesë,

•Marrja e vendimit për lirim nga taksa për mamografi.

Kryesuesi i Komitetit konstatoi se njëzëri me 8 vota Për nga anëtarët sa ishin prezent në sallë, mbështetet propozimi i anëtares së Kuvendit të Komunës dhe këtij Komiteti znj.Drita Pajaziti, për përfshirje në kuadër të rendit të ditës si pikë shtesë për këtë mbledhje dhe rekomandimin e të njëjtës për seancën e Kuvendit të Komunës.

• Marrja e vendimit për lirim nga taksa për mamografi.

z.Vigan Salihu, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik-DPZHE, theksoi, kam një propozim vendim për ngritjen e Komisionit komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike lokale – “Eko-Llapi” Sh.A, andaj nga ana e juaj shpresoj se ky propozim do të gjej mbështetje.

z.Haki Rudari, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve të LVV-së e përkrahim propozim vendim për ngritjen e Komisionit komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale – “Eko-Llapi” Sh.A, dhe i rekomandojmë Kuvendi për shqyrtim në seancën e radhës.

z.Naim Çunaku, theksoi, sigurisht se edhe ne e mbështesim këtë mirëpo kur ta kesh parasysh formimin e një Komisioni të Aksionarëve dhe në rend të parë në këtë formë kaq shpejtë pa qenë pikë e rendit të ditës të sjellët në këtë formë, vërtetë len për të diskutuar dhe e di se kohë më parë kemi pas goxha telashe për marrjen e një vendimi të tillë, po flas për një periudhë më të hershme dhe krejt çka i kam rezervat se një propozim kesi soji nuk është dashur me një procedurë të shpejtë të sjellët në Kuvend por është dashur të sjellët materiali në procedurë të rregullt me kohë që ta kemi mundësinë e shqyrtimit.

z.Bashkim Syla, theksoi, në parim e përkrahi këtë propozim, siç dihet ky vendim më herët është marrë nga Qeveria e Kosovës, tani i mbetet Komunës që të kryej punën e saj.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, nëse ka dikush diçka për të shtuar urdhëroni nëse jo atëherë e vë në votim propozimi e Ekzekutivit të Komunës, të paraqitur nga z.Vigan Salihu drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, për përfshirje në kuadër të rendit të ditës si pikë shtesë edhe Propozim vendimin për ngritjen e Komisionit komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike lokale – “Eko-Llapi” Sh.A.

Kryesuesi i Komitetit konstatoi se me 6 vota Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të Përmbajtur (të tjerët nuk votuan), mbështetet propozimi i Ekzekutivit të Komunës, i paraqitur nga z.Vigan Salihu drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, për përfshirje në kuadër të rendit të ditës si pikë shtesë edhe pika;

• Propozim vendimin për ngritjen e komisionit komunal të aksionarëve të ndërmarrjes publike lokale – “Eko-Llapi” Sh.A.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, tani e vë në votim rendin e ditës përfshirë këtu edhe dy pikat shtesë:

Kryesues i Komitetit, konstatoj se njëzëri me 8 vota Për nga anëtarët sa ishin prezent në sallë, miratohet rendi i ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, përfshirë edhe dy pikat shtesë të përkrahura parapraakisht në këtë mbledhje.

Rendi i ditës i miratuar:

1. *Procesverbal nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 26 shtator 2023.*
2. *Propozim vendimi për formimin e komisionit ad-hoc për hartimin e Draft Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024.*
3. *Propozim vendimi për vënien në konsultim publik Draft Planin Lokal i Veprimit për Barazi dhe Diskriminim në Komunën e Podujevës për periudhën 2023-2026.*
4. *Marrja e vendimit për lirim nga taksa për mamografi.*
5. *Propozim vendimin për ngritjen e komisionit komunal të aksionarëve të ndërmarrjes publike lokale – “Eko-Llapi” Sh.A.*

1. Procesverbal nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 26 shtator 2023.

Njëzëri, pa vërejtje apo plotësim ndryshime, miratohet procesverbali nga mbledhja e KPF-së e datës 26 shtator 2023, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

2. Propozim vendimi për formimin e komisionit ad-hoc për hartimin e Draft Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, është e ditur që Kuvendi i Komunës për vitin e ardhshëm miraton Planin e punës kurse KPF-ja, i paraprin kësaj, andaj duhet të formohet një komision në Kuvend prej 9 anëtarëve, prej tyre 6 anëtar janë nga radhët e Kuvendi kurse 3 anëtar tjerë nga radhët e Ekzekutivit, andaj para se të kalojmë në diskutime ju sqaroj dhe njëkohësit pres dhe kërkoj nga ana juaj që të jepni propozime për kandidatët, mirëpo ata kandidatë të jenë sa më të angazhuar në mënyrë që ta që ta përgatitim një plan të punës sa më të mirë të mundshëm.

znj.Sebastina Vokrri, theksoi, ne Grupi i LVV-së e përkrahim propozim vendimi për formimin e komisionit ad-hoc për hartimin e Draft Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024.

z.Naim Çunaku, theksoi, një prej detyrimeve që ka Kuvendi është edhe hartimi i Planit të punës mirëpo nga ajo që kemi si propozim është që në hartimin e Planit të punës së Kuvendit të ketë edhe përfaqësues nga radhët e Ekzekutivit, kisha dashur ta di bazën ligjore të Planit të punës së Kuvendit.

Duhet secili ta ketë parasysh se ky Plan i punës është i Kuvendit dhe duhet secili ta ketë parasysh se janë dy organe të ndara, Kuvendi dhe Ekzekutivi, atëherë këtu po del një “sallatë mikse” dhe po devijohet misioni i Kuvendit. Pastaj kur bisedojmë për hartimin e planeve sidomos për Planin e punës së Kuvendit ishte dashur që në këtë seancë apo në seancën e radhës edhe ne si trupë e Kuvendit si KPF, në rend të parë ta kemi Planin e punës së KPF-së, mirëpo është bërë një praktikë që të bëhet një plan sa për të thënë se kemi një plan e që në fakt nuk obligon asgjë, këtë që e them e bazoj edhe për faktin që Plani i punës i vitit të kaluar nuk është realizuar as 30%, e të mos flas për raportet e punës së KPF-së që e ka obligim ligjor dhe duhet t’i paraqes gjitha ato para Kuvendit. sido që të jetë nuk kisha dashur që të jem pjesë e një vendimmarrje këso fare jashtë kompetencave që demokracia i ndan detyrat e Kuvendit dhe Ekzekutivit që

t'i bashkojmë në planin e punës, Ekzekutivi nuk mund të jetë pjesë e hartimit të Planit të punës së Kuvendit sepse këto janë dy trupa të ndara.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, nëse ka dikush për të shtuar diçka rreth kësaj pike të rendit të ditës urdhëroni, nëse jo atëherë e vë në votim propozim vendimi për formimin e komisionit ad-hoc për hartimin e Draft Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024 sipas propozimit përkatës.

Kryesuesi i Komitetit konstatoi se me 5 vota Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të Përmbajtur, (të tjerët nuk votuan), Kuvendit të Komunës i rekomandohet për diskutim dhe shqyrtim kjo pikë e rendit të ditës sipas propozimit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

3. Propozim vendimi për vënien në konsultim publik Draft Planin Lokal i Veprimit për Barazi dhe Diskriminim në Komunën e Podujevës për periudhën 2023-2026

z.Naim Çunaku, theksoi, sigurisht se do e mbështesim këtë propozim, mirëpo prapë po thirrem në praktikën që ndodhin në Kuvend, është vërtetë shqetësuese kur propozuesi mungon dhe nuk jep sqarime, mirëpo ne kemi pas një dakordancë mes Grupeve që drejtori i drejtorisë përkatëse duhet të jetë prezent dhe ta prezantoj pikën e tij të rendit të ditës, dhe ai drejtor që nuk është prezent propozimin e tij/saj mos ta mbështesim, andaj nëse tërhiqemi nga ai dakordim do të thotë se jemi kundër parimeve tona për të cilat jemi dakorduar.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, sa di unë ky propozim ka ardh nga Nënkryetarja e Komunës, dhe dihet se ajo është në pushim.

z.Naim Çunaku, theksoi, i nderuari Kryesues në asnjë mënyrë nuk ka arsyetime se ne mund të biem ndesh me deklaratimet tona, por arsyetime s'ka sepse ka mundësi që të arsyetohet dikush tjetër e këtë e them se këtu ka praktika të mjaftueshme kur mungon një drejtor por ai drejtor e autorizon kolegun e tij.

z.Haki Rudari, theksoi, në emër të Grupit e përkrahim këtë propozim vendim për diskutim publik por në të njëjtën kohë pajtohem që iniciuesit duhet të jenë prezent në KPF dhe në seancë, dallojnë vizitat zyrtare kur bëhen jashtë vendit dhe këto ne i mirëkuptojmë që të gjithë, megjithatë gjithëherë propozuesi qoftë këshilltari apo ai nga Ekzekutivi duhet të jetë prezent për arsye se ai duhet të japë përgjigje në rast se ka pyetje nga ana e këshilltarëve.

Pasi që jemi në mbledhjen e KPF-së dhe është rekomandim për Kuvend ne si Grup e përkrahim këtë propozim vendim, por besoj se në seancë duhet të jetë prezent iniciuesi i kësaj çështje.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, nëse ka dikush për të shtuar diçka rreth kësaj pike të rendit të ditës urdhëroni, nëse jo atëherë e vë në votim propozim vendimi për vënien në konsultim publik Draft Planin Lokal i Veprimit për Barazi dhe Diskriminim në Komunën e Podujevës për periudhën 2023-2026.

Me 5 vota Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të Përmbajtur, (të tjerët nuk votuan), Kuvendit të Komunës i rekomandohet për diskutim dhe shqyrtim të kësaj pike të rendit të ditës sipas propozimit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

4. Marrja e vendimit për lirim nga taksa për mamografi

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, në fillim propozimi ishte që të hiqet taksa për mamografi për muajt e mbetur të këtij viti, tani ishte propozimi që të hiqet e tëra kjo taksë dhe shërbimi i mamografisë të jetë gjithëherë falas për qytetarët e Komunës tonë.

z.Naim Çunaku, theksoi, mendoj se formulimi i këtij propozimi duhet të jetë kështu, propozim vendim Kuvendit për marrjen e vendimit që të lirohen qytetarët e Komunës së Podujevës nga shërbimi i mamografisë nga pagesa në një afat të pa caktuar.

znj.Drita Pajaziti, theksoi, propozimi im ishte që të merret ky vendim për lirim nga shërbimi i mamografisë nëse ka bazë ligjore për një gjë të tillë.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, pas konsultimeve me zyrën ligjore ju sqaroj se kjo pagesë si tarifë është e paraparë me Rregullore për Taksa Tarifa dhe Gjoba Komunale dhe asnjë ndryshim nuk mund të bëhet pa ndryshimin e Rregullores, tani ne këtu jemi për që propozimi i znj.Drita Pajaziti të kaloj, është mirë që ne t'i propozojmë Kuvendit që të bëjnë ndryshimin e Rregullores së cekur aty ku parashihet taksa për shërbimin e mamografisë.

znj.Drita Pajaziti, theksoi, kur te paraqes propozimin në Kuvend e bëjë edhe arsyetimin e plotë.

Sqarim nga zyrtari i Zyrës Ligjore; proceduralisht ndryshimi i Rregulloreve bëhet me procedurë të njëjtë siç është miratuar, andaj këtu përfshihet edhe diskutimi publik.

z.Naim Çunaku, theksoi, këtë që e ceku zyrtari i Zyrës Ligjore e di saktë se ndryshimi i Rregulloreve duhet të bëhet sipas procedurës së njëjtë, por unë dhe nuk desha të hyjë në atë diskutim, mirëpo miqësisht më kuptoni ju si zyrtar ligjor, në një formë u inkuadruat në debat të vendimmarrjes, me gjithë mirëkuptimin por nëse dikush dëshiron të gaboje duhet ta lëmë që të gaboje, unë këtë që e thatë ju e ceka që ne mund të bëjmë propozimin për ndryshimin e Rregullores së cekur dhe kur të hyjmë në fazën e ndryshimit të Rregullores janë edhe afatet për diskutim publik etj. Për fund këtu ne jemi pozitivë dhe opozitë dhe nëse dikush dëshiron që të gaboje ne nuk e ndalim që mos të gaboje, kaq kisha për të thënë.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, ndoshta ka pasë mundësi tjera që kjo taksë të hiqet vetëm një muaj, por për këtë nuk e di nuk jam i sigurt.

z.Naim Çunaku, theksoi, pa të keqe nëse dikush ka pasë qëllim që qytetarët tanë të lirohen nga pagesa e shërbimit të mamografisë këtë ka mundur ta bëjë vetëm Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, nëse është qëllimi që të bëhet pak politikë edhe ne bëjmë pak politikë.

z.Haki Rudari, theksoi, i nderuari z.Naim Çunaku pse Drejtoria ka të drejtë ta bëjë këtë, kurse këshilltari nuk ka të drejtë.

z.Naim Çunaku, theksoi, i nderuari z.Haki Rudari askush nuk tha se ka të drejtë ose jo, nëse dëshiron dikush të bëjë politikë këtu, e thash se edhe ne kemi të drejtën që të bëjmë politikë.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, mendoj që Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ashtu siç ka marrë vendim për lirim nga taksa e shërbimit të mamografisë për një muaj ka mundur që ta marrë atë vendim deri në fund të vitit.

z.Haki Rudari, theksoi, nuk e di se si ka pas mundësi Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të marrë vendim për lirim nga taksa e shërbimit të mamografisë për një muaj, kurse këshilltari i Kuvendit mos ta ketë këtë mundësi.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, ne jemi këtu për të mos bërë gabime dhe shkelje ligjore këtu është qëllimi.

z.Haki Rudari, theksoi, ne në KPF vetëm japim rekomandime për Kuvend, vendimet e Kuvendit shkojnë në MAPL për shqyrtim të ligjshmërisë, prandaj Kuvendi le të merr vendim për këtë propozim.

z.Naim Çunaku, theksoi, nëse fillojmë të debatojmë për procedura dhe çka është KPF-ja, dhe atë që e përcakton ligji, nuk dua të merrem me këtë çështje. Tani këtu kolegu z.Haki Rudari dëshiron kësaj teme

t'i jap kahje tjetër duke potencuar që përse NN drejtori ka të drejtë ose jo të marrë një vëllim të tillë, në këtë rast edhe Kryesuesi e ceku se a ju ka pyet juve DSHMS për atë vendim që e ka marrë, a ka të drejtë Drejtoria sërish që ta marrë një vendim të tillë për heqjen e pagesës për shërbimin e mamografisë për një ose dy muaj nëse po atëherë jemi në rregull, mirëpo pa u bërë ndryshimi i Rregullores përkatëse, propozimi ka qenë dashur të bëhet kështu, të pezullohet apo suspendohet apo të hiqet pagesa për shërbimin e mamografisë, ndërsa në këtë rast atakohet Rregullorja, pra për këtë duhet të bëhet ndryshimi i Rregullores për Taksa tarifa dhe Gjoha Komunale.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, ndryshimi i Rregullores së cekur nuk mund të bëhet pa procedura, mirëpo si do që të jetë e vë në votim propozimin e znj.Drita Pajaziti që t'i rekomandohet Kuvendit të Komunës përfshirja në kuadër të rendit të ditës për diskutim dhe shqyrtim të mundësive për lirim pa pagesë nga taksa komunale e kontrolleve shëndetësore të mamografisë në QKMF – Podujevë.

Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 8 vota Për, nga anëtarët sa ishin prezent në sallë, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për përfshirje në kuadër të rendit të ditës për diskutim dhe shqyrtim të mundësive për lirim pa pagesë nga taksa komunale e kontrolleve shëndetësore të mamografisë në QKMF – Podujevë.

5. Propozim vendimin për ngritjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale – “Eko-Llapi” Sh.A.

z.Naim Çunaku, theksoi, i nderuari Kryesues, ka ardhë ky propozim por e them që një propozim kaq vital nuk ish dashur të kalojë në një procedurë pa material që do ta kishin mundësinë këshilltarët e Kuvendit Komunal ta shqyrtonin, si dhe pa qenë të njoftuar se cilat janë kompetencat dhe detyrimet e këtij komisioni, duke pasë parasysh faktin që drejtori i DPZHE në fjalën hyrëse në fillim të mbledhjes nuk ceku ndonjë afat kohor, vërejtjet tona ishin që kjo pikë e rendit të ditës të kalojë në një seancë tjetër të radhës në mënyrë që këshilltarët të pajisen me materialin bazë dhe ta marrin një vendim më meritore.

z.Haki Rudari, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së e përkrahim këtë propozim vendim dhe i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim në mënyrë që pastaj Kuvendi të marrë vendim për themelimin e këtij komisioni, emrat e anëtarëve të komisionit do t'i prezantojmë në seancën e radhës të Kuvendit.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, nëse ka dikush për të shtuar diçka rreth kësaj pike të rendit të ditës urdhëroni, nëse jo atëherë e vë në votim propozim vendimin për ngritjen e Komisionit komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko-Llapi” Sh.A.

Kryesuesi i Komitetit konstatoi se me 6 vota Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të përmbajtur (të tjerët nuk votuan), Kuvendit të Komunës rekomandohet për përfshirje në kuadër të rendit të ditës për diskutim dhe shqyrtim të kësaj pike sipas materialit të prezantuar në këtë mbledhje.

Meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi i Komitetit e konstaton të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 10:50

Procesverbalin e mbajtën;

Enis Sheholli

Osmon Bajrami

Nr.Prot.01-311/05-0078812/23

Podujevë,

27 tetor 2023

Kryesuesi i Kuvendit - Komitetit

Hilmi Hoxha